



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**Up1 Nr 08-424**  
**13.12.2021**

**Sh k u p**

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alinea 20, neni 23 paragrafi 1 alinea 4 dhe neni 85 paragrafi 1 alinea 4 dhe pika 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10 paragrafi 5 të Rregullores së punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Tekst i pastruar) akr.nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, Vendimi Up1 nr.08-424 nga 26.11.2021 për marrjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive TV NOVA SHPK Gjevgjeli, nr.08-43 nga 05.012015 dhe Konkluzioni nark.nr.02-4473/4 nga 13.12.2021, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 36-të e mbajtur më 13.12.2021, miratoi:

**Vendim**

**për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve**

1. FSHIHET nga regjistri i transmetuesve, Shoqëria transmetuese tregtare TV NOVA SHPK Gjevgjeli.
2. Vendimi publikohet në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në web faqen e Agjencisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Në pajtim me nenin 85 paragrafi 1 alinea 4 nga Ligji i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, lejen për transmetim televiziv ose për radio transmetim pushon së qenuri e vlefshme në bazë të ligjit, me marrjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin 2 të cituar nga Ligji, Agjencia do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja pushon së qenuri në pajtim me nenin 85 paragrafi 1 nga Ligji i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele.

Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në seancën e 34-të mbajtur më 26.11.2021r., në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-4259/2 nga 26.11.2021., miratoi Vendim Up1 nr.08-424 nga 26.11.2021 . me të cilën i mirret leja Shoqërisë tregtare radiodifuzive TV NOVA SHPK Gjevgjeli, nr.08-43 nga 05.012015., për shkak se pas dhënies së lejes kanë ndodhur rrethana që paraqesin pengesa ligjore për poseduesin e lejes për ta kryer aktivitetin, gjegjësisht për shkak se radiodifuzeri nuk i plotëson kushtet minimale kuadrovike të përcaktuara në Rregullore për teknikat minimale, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për emetim në radio dhe television.

Deklaruar ligjërisht, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alinea 20, neni 23 paragrafi 1 alinea 4 dhe neni 85 paragrafi 1 alinea 4 dhe paragrafi 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në pajtim me nenin 10 paragrafi 5 i Rregullores për punë e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Tekst i pastruar), Vendimin Up1 nr.08-424 nga 26.11.2021 për marrjen e lejes për emtim

televizion të Shoqërisë transmetuese tregtare TV NOVA SHPK Gjevgjeli, nr.08-43 nga 05.012015 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4473/4 nga data 13.12.2021, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në seancën e 36-të e mbajtur më 13.12.2021, miratoi vendimin si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuale,  
Kryetar i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI d.v.**

**Udhëzim ligjor:** Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për fillimin e kontestit administrativë në gjykatën e shkallës së parë. Padia për fillimin e kontestit administrativë paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Dorëzuar deri:

- Shoqërisë tregtare radiovizive TV NOVA SHPK Gjevgjeli;
- Menaxherit të shoqërisë transmetuese tregtare TV NOVA SHPK Gjevgjeli;
- Sektori për përkrahje informative dhe punë të përgjithshme-Arkiva;
- Sektori për çështje juridike dhe prokurime publike;
- Sektori për financa dhe logjistikë;
- Personi i emëruar në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për mbajtjen e regjistrit Up1; dhe
- Agjencia për komunikime elektronike në RMV